Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-353/01-74717
Dt. 16.10.2026
P r i z r e n

DREJTORATI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR KK – PRIZREN, me kërkesën e **Bashkim Çakalli** me banim në rrugën "Adem Jashari" nr.216 me numër të kërkesës **04-353/01-74717** të datës 02.07.2026 në bazë të nenit 3. pika 1.5.2;1.11 si dhe nenit 5 alineja 1 Pika 1.3 e në kuptim të nenit 14 alineja – 1 pika 1.5 dhe nenit 15 alineja 1 pika 1.1 dhe neni 19 alineja 2 të Ligjit për Ndërtim Numër 04/L-110 si dhe konform dispozitave të neneve 26 paragrafi 1, nenet 27, 44, 46, 47, 48 dhe 86 të Ligjit për Procedurën Pergjithshme Administrative-LPPA-së numër 05/L-031, e lidhur me dispozitat e neni 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe sipas vendimit për miratimin e HZK për periudhën 2022-2030 Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

I. **LEJOHET: Bashkim Çakalli** me banim në rrugën "Adem Jashari"nr.216 në zhvillimin e punimeve: **Ndërrimin e vitrinës së objektit – Lokal afarist** me numër të objektit **O-71813068-00942-1-963-3-2-0 ZK Prizren** e cila është e locuar në ngastrën kadastrale numër **P-71813068-00942-1 ,** e cila është e identifikuar sipas kopjes së planit.

II. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë të punuar nga ana e byros projektuese "ARCHIDEA"B.I. (gjendja e re dhe gjendja ekzistuese).

III. Gjatë renovimit nuk lejohet kurrfarë ndryshimi jashta projektit.

IV. Investitori duhet të përmbahet Vendimit të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve me nr.163/2026 të dt.29.07.2026

V. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspekcionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh.

VI. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

A r s y e t i m

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se: **Bashkim Çakalli me banim në rrugën "Adem Jashari" nr.216** me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për renovimin e objekteve të K Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për :

Ndërrimin e vitrinës së objektit – Lokal afarist të objektit me numër **O-71813068-00942-1-963-3-2-0 ZK Prizren** e cila është e locuar në ngastrën kadastrale numër **P-71813068-00942-1 .**

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPH së në Prishtinë, përmes këtij organi.

Bashkëpunëtor profesional:

Xhejlane Gjini, inxh. dip. ark.